



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

Shkup, 19 shkurt viti 2021

Njoftim për Shtyp

Zhvillimet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: janar, 2021

- Në janar të vitit 20201, në përputhje me dinamikën ligjore, **paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})** shënoi një rënie mujore prej 0,5%, kryesisht si rezultat i rënies së depozitave pa afat, dhe në masë më të vogël si rezultat i parave të gatshme në qarkullim dhe depozitave afatgjate deri në dy vite, në kushte të rritjes së depozitave afatshkurtra. Në bazë vjetore, paraja e gjerë M3 shënoi një rritje prej 9,0%, që në masë të madhe është si rezultat i rritjes së depozitave pa afat, dhe paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat afatshkurtra gjithashtu patën një kontribut pozitiv. Depozitat afatgjata deri në dy vjet shënuan rënie në bazë vjetore.

Tabela 1. Totali i depozitave dhe kredive^{3,4} të sektorit joqeveritar

	sostojba (во милиони денари)					годишна промена (во %)					месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020 ³	1.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020 ³	1.2021	12.2020	1.2021
Парична маса M4	455,834	468,912	469,050	486,989	484,490	8.9	9.8	6.9	6.9	7.7	3.1	-0.5
Парична маса M3	403,714	416,935	418,556	436,231	433,902	8.3	9.7	7.6	8.0	9.0	3.5	-0.5
<i>од кои:</i>												
Готови пари во оптик	37,891	41,125	41,667	43,701	43,405	21.3	26.3	24.9	21.0	27.3	5.8	-0.7
Вкупни депозити	409,200	418,916	418,644	434,915	432,539	8.3	8.4	6.1	5.9	6.3	3.0	-0.5
<i>од кои:</i>												
Корпоративен сектор	108,138	110,550	112,505	123,212	119,518	12.5	11.2	8.0	10.1	12.0	5.8	-3.0
<i>Во денари</i>	75,876	77,609	79,641	86,323	82,808	13.8	9.3	5.4	5.4	9.2	6.5	-4.1
<i>Во странска валута</i>	32,261	32,941	32,865	36,889	36,709	9.5	15.9	14.9	22.8	18.8	4.4	-0.5
Домаќинства	275,574	280,512	278,469	285,216	285,657	8.6	8.7	6.1	4.6	4.7	2.3	0.2
<i>Во денари</i>	147,532	149,204	145,806	150,991	150,011	11.9	10.1	6.2	3.3	3.9	3.8	-0.6
<i>Во странска валута</i>	128,042	131,309	132,663	134,225	135,646	5.1	7.1	6.0	6.2	5.7	0.5	1.1
Вкупни кредити	343,702	352,718	352,824	357,296	356,943	5.8	6.6	7.3	4.7	4.6	1.1	-0.1
<i>од кои:</i>												
Корпоративен сектор	167,654	172,978	168,086	169,826	169,440	1.8	4.6	5.2	1.1	1.6	1.9	-0.2
<i>Во денари</i>	103,597	106,688	101,925	102,688	102,625	0.4	3.3	2.7	-0.9	-0.1	1.9	-0.1
<i>Во странска валута</i>	64,057	66,290	66,161	67,138	66,815	4.0	6.9	9.3	4.3	4.3	2.0	-0.5
Домаќинства	174,634	178,384	183,431	185,814	185,851	10.1	8.8	9.5	8.0	7.4	0.4	0.0
<i>Во денари</i>	96,643	99,469	103,939	105,049	105,161	8.8	8.7	12.0	10.5	9.7	0.0	0.1
<i>Во странска валута</i>	77,990	78,916	79,492	80,765	80,689	11.9	8.9	6.4	5.0	4.6	1.0	-0.1

Burimi: BPRMV.

¹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetare M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

²Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf



³Normat vjetore të kredive në periudhën nga korriku 2019 këndeј janë nën ndikimin e efekteve nga masat e BPRMV-së për fshirjen e kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit.

⁴Të dhënat për agregatet monetare, si dhe totali i depozitave dhe kredive deri në gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

- Në janar, **totali i depozitave**⁵ shënon rënie mujore prej 0,5%, gjë që shpjegohet me rënien në depozitat e sektorit të korporatave. Krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, totali i depozitave u rrit për 6,3%, me kontribut pothuajse të barabartë në rritjen e të dy sektorëve.
- **Totali i kredive**⁶ në janar 2021 u ulën me 0,1%, si rezultat i uljes së huadhënies për sektorin e korporatave, ndërsa huadhënia për amvisëritë nuk pati ndryshime në bazë mujore. Në nivel vjetor, totali i kredive u rrit për 4,6%, me një kontribut më të madh drejt rritjes së sektorit „amvisëri“..



Burimi: BPRMV.

1. Depozitat dhe kreditë e sektorit të korporatave⁷



Burimi: BPRMV

⁵Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4.

⁶Më 9 gusht të vitit 2018, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi Vendimin mbi metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/18), sipas së cilës bankat janë të detyruara t'i transferojnë nga evidenca e bilancit në evidencë jashtë bilancit (dhe të vazhdojnë me transferimin e) të gjithë kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit. Vendimi për metodologjinë e administrimit të rrezikut të kredisë filloi të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2019, duke shterur kështu efektin e bazës së krahasimit në korrik të vitit 2020. Prandaj, ndryshimet në normat vjetore të ndryshimit të kredive me dhe pa efektin e fshirjeve të kryera janë të parëndësishme, për shkak të së cilës nga njoftimi i muajit gusht këndeje këto krahasime janë ndërprerë.

⁷Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin korporatat publike dhe private jo financiarë.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

- Në janar të vitit 2021, **depozitat e sektorit të korporatave** shënojnë rënie mujore prej 3,0%. Në këtë mënyrë, rënia kryesisht rezulton nga rënia e depozitave pa afat, me një kontribut më të vogël të depozitave afatshkurtra, dhe në kushte të rritjes së moderuar të depozitave afatgjata. Në bazë vjetore, depozitat janë për 12,0% më të larta, që kryesisht rezulton nga rritja e depozitave pa afat, depozitat afatshkurtra dhe afatgjata në valutë të huaj, ndërsa depozitat afatshkurtra dhe afatgjata në denarë shënojnë rënie.
- Në janar, **kreditë e sektorit të korporatave**⁸ shënuan rënie prej 0,2% në bazë mujore. Ndryshimi në rënie është para së gjithash për shkak të uljes së kredive të miratuara në valutë të huaj, me më pak ndikim të kredive në denarë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kreditë e sektorit të korporatave janë më të larta për 1,6%, gjë që reflekton plotësisht rritjen e kredive në valutë të huaj, në kushte të një rënie më të vogël në kreditë në denarë.



Burimi: BPRMV.



2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁹



Burimi: BPRMV.

- Totali i **depozitave të amvisërive** u rrit për 0,2% në bazë mujore. Ndryshimi në rritje kryesisht lind nga depozitat afatshkurtra në valutë të huaj, si dhe nga rritja e depozitave

⁸Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁹Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe personave të vetëpunësuar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

	sostojba (во милиони денари)					годишна промена (во %)					месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020 ²⁾	1.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020 ²⁾	1.2021	12.2020 ²⁾	1.2021
Потрошувачки кредити	93,440	94,982	97,850	98,772	98,023	13.5	10.0	9.9	6.9	6.3	0.5	-0.8
Станбени кредити	52,959	54,392	55,985	58,306	58,548	13.9	13.8	14.0	13.6	13.0	1.9	0.4
Автомобилски кредити	306	292	291	282	276	-4.1	-8.6	-7.9	-10.9	-10.5	-2.6	-1.9
Кредитни картички	11,570	11,508	11,649	11,205	10,900	-4.5	-4.2	-2.6	-6.1	-8.0	-1.6	-2.7
Негативни салда по тековни сметки	6,499	6,205	6,280	5,818	6,352	-4.8	-9.4	-10.8	-5.0	-8.1	-9.9	9.2
Други кредити	3,969	3,946	3,912	3,871	3,800	-6.7	-6.4	-6.7	-6.0	-6.9	0.3	-1.8

Burimi: BPRMV.

- Analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizikë, në kategorinë më të përfaqësuar - **kredi konsumatore** është regjistruar një rënie e vogël mujore prej 0,8%, ndërsa në bazë vjetore është shënuar një rritje prej 6,3%. **Kreditë banesore** shënojnë rritje mujore dhe vjetore prej 0,4% dhe 13,0%, përkatësisht. **Kreditë për makina** shënuan rënie mujore dhe vjetore prej 1,9% dhe 10,5%, përkatësisht, ndërsa kreditë e miratuara në **kartat e kreditit** ranë për 2,7% dhe 8,0% në bazë mujore dhe vjetore, përkatësisht. Këtë muaj, në **saldot negative në llogaritë rrjedhëse** është regjistruar një rritje mujore prej 9,2%, ndërsa në bazë vjetore ata janë reduktuar për 8,1%. Kreditë të miratuara në **baza tjera**, në janar, regjistrojnë rënie mujore dhe vjetore prej 1,8% dhe 6,9%, përkatësisht.

Informacione mbështetëse

Seri kohore të të dhënave: Balance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjija/Metodologjija_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesi:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 19 mars 2021 (mesatarja referuese deri në shkurt 2021).

Për pyetje gazetarësh, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 110/108).